

UNIVERSITETI I MITROVICËS

FAKULTETI EKONOMIK

**DEPARTAMENTI: BIZNES DHE MENAXHMENT (SPECIALIZIM:
BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET)**



PUNIM DIPLOME

Studente:

Gentijana ARUQI

Mentor:

Prof. Asoc. Dr: Esat DURGUTI

Mitrovicë, Tetor 2024

UNIVERSITETI I MITROVICËS

FAKULTETI EKONOMIK

**DEPARTAMENTI: BIZNES DHE MENAXHMENT (SPECIALIZIM:
BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET)**



Lënda: Menaxhment Financiar

Tema: Analiza e Rrezikut dhe Strategjitë e Menaxhimit të Rrezikut në
Investime të Ndryshme Financiare

Studente:

Gentijana ARUQI

Mentor:

Prof. Asoc. Dr: Esat DURGUTI

Mitrovicë, Tetor 2024

PUBLIC UNIVERSITY OF MITROVICA “ISA BOLETINI”

FACULTY OF ECONOMICS

**DEPARTAMENT: BUSINESS AND MANAGEMENT
(SPECIALIZATION: BANKING, FINANCE AND ACCOUNTING)**



BACHELOR THESIS

**RISK ANALYSIS AND RISK MANAGEMENT STRATEGIES IN
DIFFERENT FINANCIAL INVESTMENTS**

The Candidate:

Gentijana ARUQI

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Esat DURGUTI

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" I MITROVICËS

FAKULTETI EKONOMIK

**DEPARTAMENTI: BIZNES DHE MENAXHMENT (SPECIALIZIM: BANKA,
FINANCA DHE KONTABILITET)**



PUNIM DIPLOME

Lënda: **Menaxhment Financiar**

Titulli i punimit: **“Analiza e Rrezikut dhe Strategjitë e Menaxhimit të Rreikut në Investime të Ndryshme Financiare”**

Emri dhe mbiemri: **Gentijana ARUQI**

Statusi i studentit: **I Rregullt**

Numri i amzës (ID Regjistri): **2105031031**

Niveli i studimeve: **Bachelor**

Departamenti: **Biznes dhe Menaxhment (Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)**

Programi i studimeve: **Biznes dhe Menaxhment (Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)**

Mentori i punimit: **Prof. Asoc. Dr. Esat DURGUTI**

Aprovuar prej komisionit:

- _____ Mentor
/Emri Mbiemri, Titulli/
- _____ Anëtar
/Emri Mbiemri, Titulli/
- _____ Anëtar
/Emri Mbiemri, Titulli/

Data e aprovimit: _____

FALËNDERIME

Dua të shpreh mirënjohje dhe falënderim të thellë ndaj Zotit, për forcën, mundësitë dhe aftësitë intelektuale për gjatë këtij rrugëtimi akademik.

Një falënderim i veçantë shkon për prindërit dhe familjen time për mbështetjen e tyre të vazhdueshme morale, dashurinë dhe besimin në rrugën time, iu jam përherë falënderuese.

Dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për mentorin e kësaj teze, Prof. Asoc. Dr. Esat A Durguti, për mbështetjen e vazhdueshme, udhëzimet dhe këshillat gjatë gjithë kësaj periudhe bashkëpunimi. Pa ndihmën, inkurajimin dhe përkushtimin e tij, ky punim nuk do të ishte i mundur.

Gjithashtu, dua të falënderoj të gjithë profesorët dhe stafin akademik të cilët ishin aty në çdo sfidë, gjithmonë të gatshëm të sugjerojnë e këshillojnë të cilat kanë kontribuar në rritjen e njohurive të mia.

Në fund, dua të falënderoj të gjithë pjesëmarrësit që ndanë kohën e tyre dhe dhanë informacionet e nevojshme që kanë kontribuar në përfundimin me sukses të kësaj teme. Këtë punim ia dedikoj familjes time të dashur, për dashurinë e tyre të pakushtëzuar, mbështetjen e vazhdueshme dhe besimin në mua.

DEKLARATA E ORIGJINALITIT / AUTORËSISË

Ky punim diplome është puna ime origjinale duke respektuar autorësinë e çdo burimi të informacioneve dhe rregullave për një punim të mirëfilltë shkencorë, dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, për ndonjë gradë në këtë apo ndonjë universitet tjetër. Sipas njohurisë time, punimi nuk përmban asnjë material të botuar ose shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit.

Gjithashtu, deklaroj se, në shkrimin e punimit kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të UIBM.

STATEMENT OF ORIGINALITY / AUTHORITY

This diploma thesis, bachelor level, is my original work, respecting the authorship of any source of information and rules for a proper scientific work, and has not been submitted in whole or in part to any degree at this or any other university.

According to my knowledge, the paper does not contain any material published or written by any other person except as stated in the text.

Also, I declare that writing the thesis I have respected the ethical rules of the scientific and academic work of UIBM.

Emri/Name

Nënshkrimi/Signature

Data/Date

Përmbajtja

FALËNDERIME.....	5
DEKLARATA E ORIGJINALITIT / AUTORËSISË.....	6
STATEMENT OF ORIGINALITY / AUTHORITY.....	6
Lista e figurave	8
Lista e tabelave	8
ABSTRAKT	9
ABSTRACT.....	10
HYRJE.....	11
Sfondi i studimit.....	11
Paraqitja e problemit.....	11
KAPITULLI I PARË: EVIDENCAT TEORIKE DHE SHKENCORE MBI ANALIZIMIN E RREZIKUT	13
1.Faktorët të cilët ndikojnë në rreziqet me të cilat ballafaqohen bizneset	13
1.1.Rreziqet e brendshme.....	13
1.2.Rreziqet e jashtme.....	13
1.3.Llojet e rreziqeve	14
1.4.Procesi i menaxhimit të riskut.....	16
KAPITULLI I DYTË: METODOLOGJIA E TË DHËNAVE DHE PËRPUNIMI I TYRE....	20
2. Metodologjia.....	20
2.1.Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre.....	20
2.2. Vlerësimi i proporcioneve.....	21
2.3.Statistikat përshkruese	27
2.4. Korrelacionet.....	28
2.5. Analiza e regresionit	29
KAPITULLI I TRETË: TË GJETURAT DHE DISKUTIMET	31
KAPITULLI I KATËR: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	33
4.1. Konkluzione.....	33
4.2.Rekomandime	34
REFERENCA	36
SHTOJCË	38

Lista e figurave

Figura 1: Procesi i menaxhimit të riskut	16
--	----

Lista e tabelave

Tabela 1: Rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohen	22
Tabela 2: Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve në biznese	22
Tabela 3: Strategjitë e menaxhimit të rrezikut për mbrojtjen e investimeve	23
Tabela 4: Ndikimi i rreziqeve të papritura në strategjitë e menaxhimit të rrezikut	23
Tabela 5: Matja e sukseseve të strategjive të menaxhimit të rrezikut	24
Tabela 6: Njohuritë mbi metodat të cilat përdoren për matjen dhe vlerësimin e rrezikut	25
Tabela 7: Pozicioni në biznes	25
Tabela 8: Gjinia	25
Tabela 9: Madhësia e biznesit	26
Tabela 10: Përvoja në menaxhimin financiar	26
Tabela 11: Statistikat përshkruese	28
Tabela 12: Cilat janë rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohen bizneset	29
Tabela 13: Analiza e regresionit	30

ABSTRAKT

Qëllimi i temës së diplomës është që të identifikojë rreziqet kryesore financiare me të cilat përballen bizneset dhe që të vlerësojë efektivitetin e strategjive të përdorura për menaxhimin e këtyre rreziqeve. Ky punim trajton analizën e rrezikut dhe strategjitë e menaxhimit të rrezikut në investimet financiare, me fokus të veçantë në bizneset në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj përmes literaturës teorike dhe empirike. Metodologjia e aplikuar e hulumtimit përfshin një pyetësorë të strukturuar për të mbledhur të dhëna nga bizneset në rajonet e përmendura. Analiza e korrelacionit dhe analiza e regresionit janë përdorur për të nxjerrë përfundimet përkatëse dhe për të interpretuar të dhënat. Rreziku është një efekt i pasigurisë që ndikon në arritjen e objektivave e cila mund të shoqërohet me përparësitë dhe të metat në varësi të situatës apo ngjarjes. Rezultatet e studimit treguan se bizneset në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj përballen kryesisht me rreziqe si rreziku i tregut, rreziku i likuiditetit dhe rreziku operacional. Strategjitë më të përdorura për menaxhimin e këtyre rreziqeve përfshijnë diversifikimin e rrezikut, vlerësimi dhe monitorimi, dhe mbrojtja nga rreziku.

***Fjalët kyçe:** rreziku, menaxhimi, monitorimi, Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj.*

ABSTRACT

The aim of the diploma topic is to identify the main financial risks faced by businesses and to evaluate the effectiveness of the strategies used to manage these risks. This paper deals with risk analysis and risk management strategies in financial investments', with a special focus on businesses in Mitrovica, Vushtrri and Skenderaj through theoretical and empirical literature. The applied research methodology includes a structured questionnaire to collect data from businesses in the mentioned regions. Correlation analysis and regression analysis were used to draw relevant conclusions and interpret the data. Risk is an effect of uncertainty that affects the achievement of objectives, which can be associated with advantageous and disadvantageous consequences depending on the situation or event. The results of the study showed that businesses in Mitrovica, Vushtrri and Skenderaj mainly face risks such as market risk, liquidity risk and operational risk. The most commonly used strategies for managing these risks include risk diversification, assessment and monitoring, and hedging.

Key words: risk, management, monitoring, Mitrovica, Vushtrri, Skenderaj.

HYRJE

Menaxhimi i rrezikut është një temë që në kohët e fundit ka marrë vëmendje për shkak të krizave të ndryshme që kanë goditur. Kompanitë përdorin mjete dhe metoda të ndryshme për të ndihmuar që menaxherët të kontribuojnë me rrezikun në operacionet e tyre të përditshme dhe me sfidat që kompanitë përballen gjatë afarizmit të tyre. Risku dhe rreziku janë dy koncepte shumë të rëndësishme për shoqëritë tregtare. Rreziku mund të përkufizohet si kombinim i probabilitetit të një ngjarjeje dhe pasojave të saj (ISO/IEC Guide 73). Menaxhimi i riskut është një proces në të cilin kompanitë adresojnë rreziqet që lidhen me aktivitetet e tyre në mënyrë që të arrijnë përfitime të qëndrueshme.

Fokusi kryesor i këtij punimi është që të identifikojë dhe të trajtojë rreziqet me të cilat ballafaqohen bizneset në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj. Aplikimi i pyetësorit ka ndihmuar që të kuptojmë thellësisht se cilat janë disa nga barrierat apo problematikat me të cilat përballen këto biznese. Fillimisht në kapitullin e parë kemi të bëjmë me evidencat teorike dhe shkencore mbi analizimin e rrezikut, më pas në kapitullin e dytë përfshihen metodologjia e analizës së rrezikut e përfshirë në këtë temë, tutje në kapitullin e tretë përfshin mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e tyre të cilët ndikojnë në menaxhimin e rrezikut dhe në fund kapitulli i katërt përfshin konkluzionet dhe rekomandimet që janë nxjerrur në këtë temë diplome.

Sfondi i studimit

Roli i monitorimit dhe vlerësimit të rrezikut në një ambient ekonomik është bërë një aspekt thelbësor i menaxhimit strategjik. Mospërdorimi dhe mungesa e këtyre praktikave mund të ketë pasoja të rënda financiare, siç mund të jenë humbja e kapitalit dhe ulja e konkurrencës në treg. Ky studim synon të shqyrtojë efektivitetin e strategjive të ndryshme të menaxhimit të rrezikut gjatë periudhave të paqëndrueshmërisë ekonomike dhe gjithashtu do të ofrojë rekomandime në përmirësimin e praktikave të menaxhimit të rrezikut.

Paraqitja e problemit

Bazat e kësaj tematike janë formuar duke parashtruar në pjesën e më poshtme nëpërmjet pyetjes kërkimore dhe hipotezave të parashtruara si në vijim:

PK: Cilat janë rreziqet kryesore me të cilat ballafaqohen bizneset në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj dhe si ndikojnë strategjitë e menaxhimit të rrezikut në qëndrueshmërinë dhe suksesin e këtyre bizneseve?

Hipotezat e hulumtimit janë:

H1: Identifikimi i rreziqeve në kuadër të biznesit ndikon në mënyrë pozitive në vlerësimin e rreziqeve në investime financiare.

H2: Aplikimi i strategjive mbi menaxhimin e rrezikut ndikon pozitivisht në vlerësimin e rreziqeve në investime financiare.

H3: Rreziku i papritur ndikon negativisht në strategjinë e menaxhimit të investimeve financiare.

H4: Matja dhe vlerësimi i strategjive të aplikuara ndikojnë pozitivisht në vlerësimin e rreziqeve në investime financiare.

H5: Njohuritë mbi metodat e aplikuara në vlerësimin e rrezikut ndikojnë pozitivisht në vlerësimin e rrezikut në investimet financiare.

H6: Pozita e strukturës udhëheqëse brenda biznesit ndikon pozitivisht në vlerësimin e rrezikut në investimet financiare.

H7: Struktura gjinore ndikon negativisht në vlerësimin e rrezikut.

H8: Madhësia e biznesit është e ndërlidhur negativisht me vlerësimin e rrezikut në investimet financiare.

H9: Përvoja në menaxhim të biznesit ndikon pozitivisht në vlerësimin e rrezikut në investimet financiare.

KAPITULLI I PARË: EVIDENCAT TEORIKE DHE SHKENCORE MBI ANALIZIMIN E RREZIKUT

1. Faktorët të cilët ndikojnë në rreziqet me të cilat ballafaqohen bizneset

Dështimi për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet me të cilat përballet një organizatë mund të shkaktohet nga njohja e pamjaftueshme e rrezikut, analiza e pamjaftueshme e rreziqeve dhe dështimi për të identifikuar aktivitetet e përshtatshme të reagimit ndaj rrezikut (Hopkin, 2017).

Risku i biznesit është një faktor apo ngjarje që mund të ndikojë negativisht dhe gjithashtu pozitivisht në performancën e asaj kompanie ku mund të pengojë aftësinë e saj për të siguruar të ardhurat për investitorët e asaj kompanie dhe e kundërta e saj. Menaxhimi i riskut fillon duke përcaktuar se çfarë ne duam të arrijmë duke kuptuar faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave. Risku përkufizohet në terma financiarë si një mundësi që rezultatet ose fitimet aktuale të investimeve të ndryshojnë nga një rezultat apo kthim i pritur (Chen, 2024).

Faktorët kryesor të cilët ndikojnë në rreziqet me të cilat përballen bizneset në këtë temë janë përcaktuar rreziqet e brendshme dhe rreziqet e jashtme. Më tej, do të shqyrtohen llojet e risqeve dhe procesi i menaxhimit të riskut për të cilat do të japim sqarime tutje.

1.1. Rreziqet e brendshme

Rreziqet e brendshme përballen nga një kompani brenda organizatës së saj dhe lindin gjatë funksionimit normal të kompanisë (Beers, 2022). Rreziqet e brendshme përfshijnë faktorët të cilët ndodhen brenda ndërmarrjes dhe të cilat janë nën kontrollin e menaxhmentit. Rreziku i brendshëm është më i lehtë dhe më i besueshëm për t'u menaxhuar për arsye se ato mund të parashikohen. Faktorët kryesor që ndikojnë në rreziqet e brendshme janë si p.sh. rreziqet teknologjike, rreziqet e faktorit njeri, etj.

1.2. Rreziqet e jashtme

Rreziku i jashtëm u referohet faktorëve të cilët nuk janë nën kontrollin e ndërmarrjes dhe që mund të ndikojë në performancën e saj. Rreziku i jashtëm në krahasim me rrezikun e brendshëm nuk mund të parashikohet. Ngjarjet e jashtme që çojnë në rrezik të jashtëm nuk mund të kontrollohen nga një kompani ose nuk mund të parashikohen me një nivel të lartë besueshmërie, prandaj është e vështirë të reduktohen rreziqet e lidhura (Beers, 2022). Disa nga faktorët kryesor të cilët ndikojnë në rreziqet e jashtme

të ndërmarrjes janë rreziku ekonomik, rreziku politik, rreziku social, etj. Monitorimi në mënyrë të vazhdueshme nga ana e menaxhmentit bën që ndërmarrja të reagojë në mënyrë efektive dhe adekuate ndaj rreziqeve të jashtme.

1.3. Llojet e rreziqeve

Rreziku i tregut – është risku që të ardhurat neto dhe vlera e shoqërisë tregtare të ndryshojë për shkak të ndryshimit të çmimeve të aktiveve financiare të pjesëmarrjes, të normave të interesit, të kurseve të këmbimit dhe të çmimeve të të mirave ekonomike individualisht të pa identifikueshëm (Dhuci, 2015). Pra, risku i tregut është një nga risqet që ka efekt të humbjes për shkak të faktorëve të ndryshëm siç mund të jenë: norma e interesit, ndryshimi i çmimeve të mjeteve financiare, ndryshimi i kursit të këmbimit, çmimet e aksioneve etj. Këto ndryshime përbëjnë ngjarje risku dhe që kanë ndikim në arritjen e objektivave të ndërmarrjes. Rreziku i normës së interesit ndikon në: reduktimin e të ardhurave, reduktimin e fitimeve të parashikuara, etj. Rreziku i kursit të këmbimit ka efekt në pasqyrën e të ardhurave për shkak se mjetet (asetet) në valutë të huaj duhet të konvertohen në bazë të kursit të këmbimit në çdo raport të përcaktuar në bazë të ligjit. Rreziku i çmimeve të mallrave në një ndërmarrje është rreziku që lidhet me luhatjen e çmimeve të produkteve që ndërmarrja prodhon. Këto ndryshime janë efekt i faktorëve të ndryshëm si politik, fatkeqësi natyrore, kërkesa dhe oferta, etj. Rreziku i çmimeve të aksioneve është rezultat që varet nga performanca financiare e ndërmarrjeve, inflacioni, ndryshimet e ndryshme ekonomike dhe zhvillimet ekonomike.

Rreziku operacional – Ngjarjet të cilat prishin funksionimin normal të organizatës quhet risk operacional. Rreziku operacional përcaktohet si rreziku i humbjeve që vijnë si rezultat nga mospërputhshmëria e procedruave, proceseve, rregulloreve të parapara nga ndërmarrja. Rreziku operacional përfshin gabimet e të punësuarve, sistemeve, teknologjia. Rreziku operacional ndodhë kur aktivitetet e përditshme të një biznesi kërcënojnë të ulin fitimet e tij (Indeed Editorial Team, 2024). Rreziku operacional mund të ndodhë dhe lidhet me mënyrën se si ndërmarrjet janë të aftë të menaxhojnë operacionet e përditshme. Rreziku operacional është rezultat i të punësuarve të paafte që mund të lënë pasoja të mëdha si: mashtrime, tregti të papërgjegjshme apo dhe vjedhje.

Rreziku i likuiditetit – Likuiditetit përcakton aftësinë e ndërmarrjes në shndërrimin e aktiveve (mjeteve) në para për të përmbushur detyrimet e saj për një periudhë të shkurtër kohore. Likuiditeti i referohet pamundësisë në një kohë të caktuar që ndërmarrjet për t'iu përgjigjur ose për të përballuar detyrimeve financiare të papritura. Aftësia paguese i nënshtrohet sinkronizimit të ritmit të arkëtimeve të lidhura me shndërrimin e aktiveve në para me nxjerrjet nga arkat në funksion të arritjes së borxheve me afat pagese (Ameleon, 2006). Pra, likuiditeti u referohet fluksit ditor të parave. Rreziku i likuiditetit lind kur një ndërmarrje ka nevojë për para por që ka një aktiv (mjet) i vlefshëm që nuk mund të tregtohet për arsye se është e vështirë të gjendet një blerës apo edhe për shkaqe të tjera si kushtet joefikase të tregut. Ndërmarrjet mund ta shmangin rrezikun e likuiditetit duke pasur parasysh nevojat afatshkurtra të parave. Ato mjete të cilat janë të vështira për t'u tregtuar apo për t'u shitur paraqesin rrezik likuiditeti. Pra, likuiditeti me fjalë të tjera paraqet se sa lehtë një mjet mund të shitet dhe të shndërrohet në para të gatshme në një treg.

Rreziku i kredisë – është rezultat që krijohet nga ndryshimet jo pozitive në situatat ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve në një marrëdhënie shkëmbimi financiar. Rreziku kreditor përkufizohet si risku që debitorët shfaqin si rezultat i paaftësisë për të paguar detyrimet/pagesat (në madhësi ose kohë) si rezultat i arsyeve objektive ose subjektive ku përfshihen përkeqësimet e situatës financiare, ekonomike sikurse dhe importimi i tyre (Shkrepa dhe Dhana, 2015). Rreziku i kredisë rrjedh nga efektet negative financiare të ndërmarrjes që vijnë si rezultat i mos përmbushjes së detyrimeve dhe mos pagesës të ndërmarrjeve. Rreziku i kredisë është një nga shqetësimet dhe një nga barrierat më të mëdha që qoftë individ e në këtë rast ndërmarrje mund të përballët. Rreziku i kredisë mund të shihet në dy këndvështrime: a) rreziku i kredisë në shlyerje dhe rreziku i kredisë para shlyerjes dhe b) rreziku i drejtpërdrejtë i kredisë dhe rreziku i tërthortë i kredisë.

Rreziku i valutës (monedhës) – është risku që të ardhurat neto apo vlera e shoqërisë tregtare të ndryshojë për shkak të ndryshimit të çmimit të një monedhe kundrejt tjetrës ose ndryshimit të kursit të këmbimit të një monedhe kundrejt tjetrës (Dhuci, 2015). Rreziku i monedhës mund të shfaqet si pasojë e a) rrezikut nga transaksionet dhe si rezultat i b) rrezikut nga kursi i këmbimit. Rreziku i transaksionit është rreziku nga të

cilat kurset e këmbimit mund të ndryshojnë dhe që ka pasoja tek ndërmarrjet duke ndikuar në të ardhurat e saj. Pra, rreziku i transaksionit ka të bëjë me ndryshimin e kursit të këmbimit dhe që ka efekt në rrjedhën e parasë (cash flow) të ndërmarrjes. Rreziku i kursit të këmbimit lidhet me kontabilitetin. Kjo do të thotë që rreziku nga kursi i këmbimit përfshin ndikimin e kursit të këmbimit mbi zërat e bilancit, humbje ose fitim përgjatë prezantimit të pasqyrave financiare.

1.4. Procesi i menaxhimit të riskut

Procesi i menaxhimit të riskut është një bashkësi veprimesh që ndërmerren nga menaxhmenti i riskut në përpjekje të vazhdueshme për të reduktuar risqet që ndërmarrja përballet. Faza e parë për një organizatë është që të vendosë për strategjinë që ajo kërkon të ofrojë. Me fjalë të tjera, strategjia e organizatës duhet të jetë efektive dhe efikase (Hopkin, 2017). Procesi i menaxhimit të riskut përfshin katër procese të rëndësishme që janë a) identifikimi i riskut, b) analiza dhe vlerësimi i riskut, c) trajtimi i riskut dhe d) monitorimi dhe rishikimi i riskut.




Figura 1: Procesi i menaxhimit të riskut

Në figurën 1, shohim katër proceset themelore të menaxhimit të riskut 1) identifikimi i riskut që është hapi i parë ku identifikohen rreziqet kryesore, 2) analiza dhe vlerësimi i riskut, që pas identifikimit duhet të analizohen dhe vlerësohen këto rreziqe për të

kuptuar ndikimin e tyre në ndërmarrje, 3) trajtimi i riskut që përfshin minimizimin dhe menaxhimin e këtyre rreziqeve si transferimi, shmangia dhe pranimi, dhe në fund 4) monitorimi dhe rishikimi i riskut që përfshin monitorimin e kontrolleve që janë kryer. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarjet apo situatat e mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes (Kontrolli i lartë i shtetit, 2018).

Identifikimi i riskut – Procesi i identifikimit të riskut duhet të jetë një proces formal që përfshin ngjarjet e riskut, burimet e riskut, shkaqet dhe pasojat e riskut. Identifikimi i riskut është procesi i njohjes, përshkrimit të riskut dhe faktorëve të brendshëm apo të jashtëm, që shkaktojnë këtë risk (Komisionarët publikë, 2022). Përmes procesit të identifikimit të riskut ndërmarrjes i mundësohet që të identifikojë burimet e riskut, pasuritë dhe pasojat e riskut. Një program i suksesshëm i menaxhimit të rrezikut ndihmon një organizatë të marrë parasysh gamën e plotë të rreziqeve me të cilat përballen. Gjithashtu, menaxhimi i rrezikut shqyrton marrëdhëniet midis llojeve të ndryshme të rreziqeve të biznesit dhe ndikimit që mund të kenë tek qëllimet strategjike të një ndërmarrje (Tucci, 2023). Pas identifikimit të riskut, ndërmarrja është e gatshme që të kalojë në fazën e analizës dhe vlerësimit të riskut.

Analiza dhe vlerësimi i riskut– Pas procesit të identifikimit të riskut, secili risk analizohet për të përcaktuar nëse risku është i pranueshëm ose jo. Ndërmarrjet duhet që të bëjnë dallimin në mes rrezikut të pranueshëm dhe të papranueshëm (nëse risku është i papranueshëm duhet modifikuar), duke përdorur teknikën sasiore dhe cilësore. Gjatë fazës së vlerësimit të rrezikut, menaxherët përcaktojnë se cilat janë rreziqet që më së shumti janë prezent në aktivitetet afariste të ndërmarrjeve. Vlerësimi i riskut përcakton nivelin e prezencës dhe efekteve të një risku të veçantë, si dhe trendin e zhvillimit, menaxhimit apo kontrollit të tij (Shkrepa dhe Dhana, 2015). Vlerësimi i rrezikut është një proces thelbësor për të kuptuar nëse rreziku duhet të eliminohet, të pranohet, të reduktohet apo edhe të bartet apo të transferohet. Vlerësimi i riskut duhet të fokusohet në të gjitha aspektet që lidhen me punën duke marrë në konsideratë jo vetëm parandalimin e aksidenteve, substancat e faktorët e rrezikshëm, sigurinë e pajisjeve teknike dhe proceseve, por edhe situatat të cilat sjellin ngarkesë fizike, mendore, të

ndjeshmërisë ose stresit (Inspektorati shtetëror i punës dhe shërbimeve shoqërore, 2024).

Trajtimi i riskut – Në një ndërmarrje, menaxhmenti i riskut duhet të kujdeset që niveli i riskut të jetë sa më i ulët që të jetë e mundur në mënyrë që ai mund të drejtohet. Pasi të identifikohen dhe vlerësohen problemet dhe rreziqet e mundshme, menaxherët duhet t'u përgjigjen atyre. Së pari, ata sigurojnë që dikush të marrë përgjegjësinë për ekzekutimin e vendimit dhe për të siguruar që ai të ndiqet. Së dyti, ata ekzekutojnë përgjigjen e vendosur ndaj rrezikut - vazhdojnë të monitorojnë, veprojnë menjëherë për të zvogëluar ndikimin ose për të filluar përmirësime për të parandaluar përsëritjen e problemit, në të ardhmen (Nasteckiene, 2021). Tek trajtimi i riskut përfshihet ndarja e riskut dhe menaxhimi i riskut për të zbatuar kontrollet për të shmangur, minimizuar ose pranuar rrezikun. Trajtimi i riskut është një proces i përmirësimit të kontrolleve, zbatimit dhe planifikimit për trajtimin e riskut.

Monitorimi dhe rishikimi i riskut – Procesi i fundit i menaxhimit të riskut është monitorimi dhe rishikimi i riskut i cili ka për qëllim monitorimin e kontrolleve të kryera, ekzaminimin e progreseve të trajtimit për të siguruar që aktivitetet e ndaluara po shmangen. Risku që dikur ishte efektiv mund të bëhet joefektiv, që mund të ndikojë të ndryshojë të gjitha objektivat e ndërmarrjes. Monitorimi përfshin rishikimin e riskut, mbikëqyrjen e procesit si dhe rishikimet e brendshme të metodave të matjes së riskut (Dhuci, 2015). Revizionimi i riskut është një proces nëpërmjet të cilit ndërmarrjet apo bizneset vlerësojnë në qoftë se procesi i drejtimit të riskut funksionon në mënyrë të duhur dhe me efektivitet. Asnjë investim nuk duhet të ndërmerret nëse shkalla e pritshme e kthimit nuk është mjaft e lartë për të kompensuar investitorin për rrezikun e perceptuar të investimit (Brigham dhe Ehrhardt, 2017). Mënyrë efektive për monitorimin dhe rishikimin e riskut është që të përvetësojnë dhe të mësojnë nga dështimet dhe sukseset e mëhershme për të adresuar riskun. Procesi i monitorimit duhet të ofrojë sigurinë se ekzistojnë kontrolle të përshtatshme për aktivitetet e organizatës dhe se procedurat janë kuptuar dhe ndjekur (IRM, 2002).

Rreziqet e strategjisë nuk mund që të menaxhohen përmes vetëm një modeli kontrolli të bazuar në disa rregulla. Në vend të kësaj, nevojitet një sistem i menaxhimit të rrezikut, i cili krijohet për të reduktuar probabilitetin në të cilat rreziqet e supozuara të materializohen dhe gjithashtu për të përmirësuar aftësinë e kompanisë që të menaxhojë

apo kontrolloj ngjarjet e rrezikut që ndodhin (Kaplan dhe Mikes, 2012). Pra, përmes krijimit të një sistemi të menaxhimit të rrezikut përmirësojmë aftësinë e ndërmarrjes apo bizneseve për të përballuar ngjarjet e paparashikuara dhe për të minimizuar ndikimin e tyre financiar.

KAPITULLI I DYTË: METODOLOGJIA E TË DHËNAVE DHE PËRPUNIMI I TYRE

2. Metodologjia

Ky punim diplome është bazuar në hulumtim empirik, i cili ka për qëllim që të mbledhë të dhëna të besueshme dhe të sakta për të vlerësuar risqet në bizneset në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj përmes pyetësorit të strukturuar. Kjo temë diplome ka prioritet në variablat si a) cilat janë rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohen bizneset, b) si i identifikoni dhe i vlerësoni ju këto rreziqe në biznesin tuaj, c) cilat strategji të menaxhimit të rrezikut përdorni për të mbrojtur investimet tuaja, d) si ndikojnë rreziqet e papritura në strategjitë tuaja të menaxhimit të rrezikut, e) si e matni suksesin e strategjive tuaja të menaxhimit të rrezikut, f) a keni njohuri mbi metodat të cilat përdoren për matjen dhe vlerësimin e rrezikut, g) cili është pozicioni juaj në biznes, h) gjinia juaj, i) cila është madhësia e biznesit tuaj, dhe j) përvoja juaj në menaxhimin financiar. Në këtë punim është përdorur analiza e korrelacionit dhe analiza e regresionit për të verifikuar shkallën e ndikimit të këtyre variablave. Metodologjia e aplikuar në këtë punim përfshin burimet primare dhe burimet sekondare për të vlerësuar rrezikun.

2.1. Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre

Në këtë pjesë të punimit përfshihen të gjitha metodat që janë përdorur për të mbledhur të dhënat të cilat janë të besueshme në këtë studim. Për më tepër, kjo pjesë përmban burimet primare të cilat janë mbledhur drejtpërdrejtë nga pjesëmarrësit përmes pyetësorit të strukturuar. Pyetësi i përfshirë në këtë studim përbëhet nga pyetje të hapura dhe të mbyllura. Pyetjet në fillim kanë për qëllim identifikimin e bizneseve dhe risqeve kryesore me të cilat përballen, tutje pjesa e dytë përqendrohet tek ndikimi i këtyre rreziqeve në performancat e këtyre bizneseve dhe tek pjesa e fundit e pyetësorit përqendrohet në strategjitë që përdorin këto biznese për menaxhimin e këtyre rreziqeve.

Pyetësi është shpërndarë me një mostër duke filluar nga 30 deri 60 biznese të vogla dhe të mesme në rajonin e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe në Skenderaj. Përzgjedhja e pjesëmarrësve u bë në mënyrë të rastësishme, duke siguruar sektorë të ndryshëm të industrisë. Për përpunimin e të dhënave të mbledhura nga pyetësi është aplikuar programi STATA për të nxjerrur:

- Vlerësimi i proporcioneve,
- Statistikat përshkruese,
- Analiza e korrelacionit,
- Analiza e regresionit

Si burime sekondare në këtë temë të diplomës janë përdorur publikime shkencore dhe libra nga autorë të ndryshëm lidhur me fushën e hulumtuar.

2.2. Vlerësimi i proporcioneve

Vlerësimi i proporcioneve në këtë temë na mundëson që të analizojmë shpërndarjen e variablave në raport me kategoritë specifike të këtyre variablave. Tabelat e mëposhtme paraqesin përqindjen e variablave kyçe i cili reflekton në shpërndarjen e përgjigjeve për secilin faktor të vlerësuar, së bashku me gabimin standard i cili shërben për të vlerësuar se sa e saktë është përqindja për të gjitha variablat. Dhe në fund, për përcaktimin e shkallës së besueshmërisë të këtyre variablave është llogaritur intervali i besueshmërisë 95 për qind, i cili tregon vlerën reale se sa të qëndrueshme dhe të besueshme janë këto vlerësime.

Në tabelën 1, mund të shohim përmbledhjen e rreziqeve kryesore financiare me të cilat ballafaqohen bizneset. Rreziku i tregut (Rreziku 1) përfaqëson 45.65 për qind të bizneseve, duke e bërë që ky rrezik të jetë rreziku që më së shumti ballafaqohen bizneset. Ky rrezik ka një gabim standard prej 7.34 për qind dhe sipas intervalit të besueshmërisë prej 95 për qind, përqindja reale mund të jetë në mes 31.64 për qind dhe 60.39 për qind. Rreziku i kredisë (Rreziku 2) prek 13.04 për qind të bizneseve, me një gabim standard 4.96 për qind. Intervali i besueshmërisë është në mes 5.85 për qind dhe 26.59 për qind. Rreziku i likuiditetit (Rreziku 3) paraqet 8.69 për qind të bizneseve që ballafaqohen me këtë rrezik, gabimi standard 4.15 për qind dhe intervali i besueshmërisë në këtë kategori është në mes 3.21 për qind dhe 21.46 për qind. Rreziku i valutës (Rreziku 4) përfaqëson 6.52 për qind të bizneseve, me një gabim standard 3.64 për qind dhe intervali i besueshmërisë është në mes 20.53 për qind dhe 18.85 për qind. Rreziku operacional (Rreziku 5) paraqet 21.74% të bizneseve, gabimi standard është 6.08 për qind, ndërsa intervali i besueshmërisë është në mes 11.91 për qind dhe 36.33 për qind. Dhe në fund, rreziqet tjera (Rreziku 6) përfaqëson 43.48 për qind të bizneseve, me një gabim standard 3 për qind dhe intervali i besueshmërisë në këtë kategori është në mes 10.48 për qind dhe 16.32 për qind.

Tabela 1: Rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohen

	Proporcioni	Gabimi standard	Logit [95% conf. interval]	
Cilat janë rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohet biznesi juaj?				
1	45.65	7.34	31.64	60.39
2	13.04	4.96	5.85	26.59
3	8.69	4.15	3.21	21.46
4	6.52	3.64	20.53	18.85
5	21.74	6.08	11.91	36.33
6	43.48	3.00	10.48	16.32

Burimi: Kalkulimet e autorit

Në tabelën 2, shohim përmbledhjen e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve në biznese. Konsultimi me ekspertë (Kategoria 1) përfaqëson 32.61 për qind të bizneseve të cilët aplikojnë konsultimin me ekspertë për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në biznese. Gabimi standard në këtë kategori varion në 6.91 për qind, ndërsa intervali i besueshmërisë është në mes 20.43 për qind dhe 47.69 për qind. Analiza statistikore (Kategoria 2) paraqet 67.39 për qind të bizneseve të cilët përdorin analiza statistikore për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, me një gabim standard të njëjtë sikur në kategorinë e parë prej 6.91 për qind, dhe intervali i besueshmërisë varion në mes 52.31 për qind dhe 79.57 për qind.

Tabela 2: Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve në biznese

	Proporcioni	Gabimi standard	Logit [95% conf. interval]	
Si i identifikoni dhe i vlerësoni ju këto rreziqe në biznesin tuaj?				
1	32.61	6.91	20.43	47.69
2	67.39	6.91	52.31	79.57

Burimi: Kalkulimet e autorit

Në tabelën 3, vërejmë strategjitë e menaxhimit të rrezikut për mbrojtjen e investimeve në biznese. Diversifikimi i rrezikut (Kategoria 1) prek 10.87 për qind të bizneseve të cilët aplikojnë këtë kategori si strategji të menaxhimit të rrezikut për t'i mbrojtur investimet e tyre, me një gabim standard prej 4.59 dhe intervali i besueshmërisë është në mes 4.49 për qind dhe 24.05 për qind. Vlerësimi dhe monitorimi (Kategoria 2) paraqet 67.39 për qind të bizneseve të cilët përdorin këtë kategori, duke bërë këtë që kjo kategori të jetë kategoria që bizneset e aplikojnë më së shumti si strategji për t'i mbrojtur investimet e tyre, me një gabim standard prej 6.91 për qind. Intervali i besueshmërisë është në mes 52.31 për qind dhe 79.57 për qind. Mbrojtja nga rreziku (Kategoria 3) përfaqëson 21.74 për qind të bizneseve të cilët aplikojnë këtë kategori,

gabimi standard varion në 6.08 për qind dhe intervali i besueshmërisë është në mes 11.91 për qind dhe 36.33 për qind.

Tabela 3: Strategjitë e menaxhimit të rrezikut për mbrojtjen e investimeve

	Proporcioni	Gabimi standard	Logit [95% conf. interval]	
Cilat strategji të menaxhimit të rrezikut përdorni për të mbrojtur investimet tuaja?				
1	10.87	4.59	4.49	24.05
2	67.39	6.91	52.31	79.57
3	21.74	6.08	11.91	36.33

Burimi: Kalkulimet e autorit

Tabela 4, tregon mbi ndikimin e rreziqeve të papritura në strategjitë e menaxhimit të rrezikut. Kategoria 1 (Kërkojnë rishikim dhe ndryshim të plotë të strategjive ekzistuese) përfaqëson 21.74 për qind të bizneseve, me një gabim standard 6.08 dhe sipas intervalit të besueshmërisë është në mes 11.91 për qind dhe 36.33 për qind. Kategoria 2 (Kërkojnë ndryshime të pjesshme dhe përshtatje të strategjive aktuale) prek 52.17 për qind të bizneseve, që e bënë këtë një prej kategorive që bizneset e përdorin më shumë. Gabimi standard në këtë kategori është 7.37 për qind, ndërsa intervali i besueshmërisë është në mes 37.58 për qind dhe 66.41 për qind. Kategoria 3 (Kërkojnë vetëm përmirësime të vogla në strategjitë aktuale) paraqet 13.04 për qind të bizneseve, me një gabim standard 4.96. Intervali i besueshmërisë varion në mes 5.85 për qind dhe 26.59 për qind. Kategoria 4 (Nuk kërkojnë ndryshime në strategjitë aktuale) përfaqëson 2.17 për qind të bizneseve. Gabimi standard është 2.15 për qind dhe intervali i besueshmërisë në këtë kategori është 0.29 për qind dhe 14.55 për qind. Kategoria 5 (Nuk jam i sigurt se si ndikojnë) paraqet 10.87 për qind të bizneseve, me një gabim standard 4.59. Intervali i besueshmërisë në këtë kategori është në mes 4.49 për qind dhe 24.05 për qind.

Tabela 4: Ndikimi i rreziqeve të papritura në strategjitë e menaxhimit të rrezikut

	Proporcioni	Gabimi standard	Logit [95% conf. interval]	
Si ndikojnë rreziqet e papritura në strategjitë tuaja të menaxhimit të rrezikut?				
1	21.74	6.08	11.91	36.33
2	52.17	7.37	37.58	66.41
3	13.04	4.96	5.85	26.59
4	2.17	2.15	0.29	14.55
5	10.87	4.59	4.49	24.05

Burimi: Kalkulimet e autorit

Në tabelën 5, mund të shohim përmbledhjen se si bizneset në Mitrovicë, Vushtri dhe Skenderaj bëjnë matjen e sukseseve të strategjive të menaxhimit të rrezikut. Analiza e

kthimit mbi investimin (Kategoria 1) paraqet 23.91 për qind të bizneseve, me një gabim standard prej 6.29 për qind dhe intervali i besueshmërisë është në mes 13.54 për qind dhe 38.67 për qind. Reduktimi i humbjeve financiare (Kategoria 2) përfshin 26.09 për qind të bizneseve të cilët aplikojnë këtë kategori duke përfshirë gabimin standard 6.47 për qind, dhe intervali i besueshmërisë është në mes 15.22 për qind dhe 40.97 për qind. Stabiliteti dhe qëndrueshmëria e protofolit (Kategoria 3) përfaqëson 43.48 për qind të bizneseve, duke e bërë një prej kategorive që bizneset e aplikojnë më shumë për matjen e sukseseve të strategjive të menaxhimit të rrezikut. Kategoria 3 paraqet gabimin standard 7.30 për qind, ndërsa intervali i besueshmërisë në këtë kategori paraqet vlerën reale në mes 29.70 për qind dhe 58.3 për qind.

Tabela 5: Matja e sukseseve të strategjive të menaxhimit të rrezikut

	Proporcioni	Gabimi standard	Logit [95% conf. interval]	
Si e matni suksesin e strategjive tuaja të menaxhimit të rrezikut?				
1	23.91	6.29	13.54	38.67
2	26.09	6.47	15.22	40.97
3	43.48	7.30	29.70	58.3

Burimi: Kalkulimet e autorit

Në tabelën 6, shohim përmbledhjen e njohurive mbi metodat të cilat përdoren për matjen dhe vlerësimin e rrezikut. Distribucioni i probabilitetit (Kategoria 1) paraqet 58.69 për qind të bizneseve të cilat përdorin këtë metodë për matjen dhe vlerësimin e rrezikut, me një gabim standard 7.26 për qind. Intervali i besueshmërisë është në mes 43.47 për qind dhe 72.20 për qind. Kthimi i pritur (Kategoria 2) prek 26.09 për qind të bizneseve, ku gabimi standard është 6.47 për qind, ndërsa intervali i besueshmërisë është në mes 15.22 për qind dhe 40.97 për qind. Devijimi standard (Kategoria 3) përfshin 10.87 për qind të bizneseve, me një gabim standard 4.59 për qind. Intervali i besueshmërisë është në mes 4.49 për qind dhe 24.05 për qind. Koeficienti i variacionit (Kategoria 4) përfaqëson 4.35 për qind të bizneseve të cilët e përdorin këtë metodë, duke e bërë që kjo të jetë metoda më pak e përdorur për vlerësimin dhe matjen e rrezikut me të cilat ballafaqohen bizneset, me një gabim standard 3 për qind. Intervali i besueshmërisë në këtë kategori është 1.05 për qind dhe 16.32 për qind.

Tabela 6: Njohuritë mbi metodat të cilat përdoren për matjen dhe vlerësimin e rrezikut

	Proporcioni	Gabimi standard	Logit [95% conf. interval]	
A keni njohuri mbi metodat të cilat përdoren për matjen dhe vlerësimin e rrezikut?				
1	58.69	7.26	43.74	72.20
2	26.09	6.47	15.22	40.97
3	10.87	4.59	4.49	24.05
4	4.35	3.00	1.05	16.32

Burimi: Kalkulimet e autorit

Në tabelën 7, shohim përmbledhjen në pozicionin e të anketuarve në pyetëtorin e strukturuar. Kategoria 1 (Menaxher / CEO) përfaqëson 73.91 për qind të bizneseve, duke bërë kategorinë më të lartë në këtë variabël. Gabimi standard është 6.47 për qind, ndërsa intervali i besueshmërisë është në mes 59.03 për qind dhe 84.78 për qind. Kategoria 2 (Pronar) përfaqëson 17.39 për qind të bizneseve, me një gabim standard 5.59 për qind. Intervali i besueshmërisë është në mes 8.77 për qind dhe 31.55 për qind. Dhe në fund, kategoria 3 (Tjetër) paraqet 8.69 për qind të bizneseve, me një gabim standard 4.15 për qind, ndërsa intervali i besueshmërisë është në mes 3.21 për qind dhe 21.46 për qind.

Tabela 7: Pozicioni në biznes

	Proporcioni	Gabimi standard	Logit [95% conf. interval]	
Cili është pozicioni juaj në biznes?				
1	73.91	6.47	59.03	84.78
2	17.39	5.59	8.77	31.55
3	8.69	4.15	3.21	21.46

Burimi: Kalkulimet e autorit

Tabela 8, tregon përmbledhjen mbi gjininë e të anketuarve të cilët veprojnë brenda biznesit. Kategoria 1 (Femër) përfaqëson 82.61 për qind të bizneseve. Gabimi standard në këtë kategori është 5.59 për qind, ndërsa intervali i besueshmërisë është në mes 68.45 për qind dhe 91.23 për qind. Kategoria 2 (Mashkull) paraqet 17.39 për qind të bizneseve, duke e bërë që kjo kategori të jetë më e ulët në raport me kategorinë e parë. Gabimi standard në këtë kategori 5.59 për qind, ndërsa intervali i besueshmërisë është në mes 8.77 për qind dhe 31.55 për qind.

Tabela 8: Gjinia

	Proporcioni	Gabimi standard	Logit [95% conf. interval]	
Gjinia juaj?				
1	82.61	5.59	68.45	91.23
2	17.39	5.59	8.77	31.55

Burimi: Kalkulimet e autorit

Në tabelën 9, shohim përmbledhjen mbi madhësinë e bizneseve. Mikro ndërmarrje (Kategoria 1) përfaqëson 71.74 për qind të bizneseve, me një gabim standard 6.64 për qind. Intervali i besueshmërisë është në mes 56.76 për qind dhe 83.08 për qind. Ndërmarrje e vogël (Kategoria 2) paraqet 21.74 për qind të bizneseve. Gabimi standard është 6.08 për qind, ndërsa intervali i besueshmërisë është në mes 11.91 për qind dhe 36.33 për qind. Ndërmarrje e mesme (Kategoria 3) përfaqëson 6.52 për qind të bizneseve, me një gabim standard 3.64 për qind. Intervali i besueshmërisë në këtë kategori varion në mes 2.05 për qind dhe 18.85 për qind.

Tabela 9: Madhësia e biznesit

	Proporcioni	Gabimi standard	Logit [95% conf. interval]	
Cila është madhësia e biznesit tuaj?				
1	71.74	6.64	56.76	83.08
2	21.74	6.08	11.91	36.33
3	6.52	3.64	2.05	18.85

Burimi: Kalkulimet e autorit

Në tabelën 10, shohim përmbledhjen mbi përvojën në menaxhimin financiar. Kategoria 1 (Më pak se 1 vit) përfaqëson 10.87 për qind të bizneseve, gabimi standard është 4.59 për qind. Intervali i besueshmërisë është në mes 4.47 për qind dhe 24.05 për qind. Kategoria 2 (1 – 3 vite) paraqet 10.87 për qind të bizneseve, njëjtë si në kategorinë e parë. Gabimi standard është 4.59 për qind, dhe në fund intervali i besueshmërisë në këtë kategori është në mes 4.47 për qind dhe 24.05 për qind. Kategoria 3 (3 – 5 vite) përfaqëson 17.39 për qind, me një gabim standard 5.59 për qind. Intervali i besueshmërisë është në mes 8.77 për qind dhe 31.55 për qind. Kategoria 4 (Më shumë se 5 vite) përfaqëson 60.87 për qind të bizneseve, me një gabim standard 7.19 për qind. Intervali i besueshmërisë është në mes 45.84 për qind dhe 74.08 për qind.

Tabela 10: Përvoja në menaxhimin financiar

	Proporcioni	Gabimi standard	Logit [95% conf. interval]	
Përvoja juaj në menaxhimin financiar?				
1	10.87	4.59	4.47	24.05
2	10.87	4.59	4.47	24.05
3	17.39	5.59	8.77	31.55
4	60.87	7.19	45.84	74.08

Burimi: Kalkulimet e autorit

2.3. Statistikat përshkruese

Në këtë temë janë analizuar disa variabla të rëndësishme duke përfshirë një mostër prej 46 vëzhgimesh. Qëllimi kryesor është që të vlerësohen karakteristikat kryesore të variablave duke filluar përmes masave përshkruese si: vlera mesatare, devijimi standard, vlera minimale dhe vlera maksimale. Nga rezultatet e paraqitura në tabelën 11 mund të shohim se variabla e parë ka një vlerë mesatare 2.59 për qind, me një devijim standard të lartë 1.78. Vlera më e ulët e rreziqeve kryesore financiare me të cilat ballafaqohen bizneset është 1 për qind, ndërsa vlera më e lartë e arritur është 6 për qind. Tek, variabla e dytë, vlera mesatare është 1.67 për qind, me një devijim standard .47. Vlera më e lartë e identifikimit dhe vlerësimit të këtyre rreziqeve varion me 2 për qind, ndërsa vlera më e ulët është 1 për qind. Më pas, tek variabla e tretë ka një vlerë mesatare 2.11 për qind dhe me një devijim standard .57 për qind. Vlera minimale e arritur është 1 për qind, ndërsa vlera maksimale varion në 3 për qind. Tutje, tek variabla e katërt vlera mesatare është 2.28 me një devijim standard 1.17. Vlera minimale është 1 për qind dhe në fund vlera maksimale e arritur në këtë variabël është 5 për qind. Më pas, vlera mesatare tek variabla e pestë është 2.33 për qind, devijimi standard .92 për qind. Vlera minimale është 1 për qind, ndërsa vlera maksimale varion në 4 për qind. Vlera mesatare tek variabla e gjashtë është 1.61 për qind me një devijim standard .85 për qind.

Vlera maksimale në këtë variabël varion në 4 për qind dhe në fund vlera minimale 1 për qind. Tutje, tek vlera mesatare tek variabla e shtatë është 1.35 për qind me një devijim standard .64 për qind. Vlera minimale e arritur është 1 për qind, ndërsa vlera maksimale 3 për qind. Vlera mesatare në variablën e tetë është 1.17 për qind, devijimi standard .38 për qind, vlera minimale varion në 1 për qind, ndërsa ajo mesatare është 2 për qind. Më pas, vlera mesatare e arritur në variablën e nëntë është 1.35 për qind me një devijim standard .60 për qind. Vlera minimale e arritur është 1 për qind, ndërsa vlera mesatare është 3 për qind. Dhe në fund, vlera mesatare e arritur në variablën e fundit është 3.28 për qind, devijimi standard .60 për qind. Vlera minimale e arritur është 1.05 për qind. Vlera minimale e arritur në këtë variabël është 1 për qind, ndërsa vlera mesatare është 4 për qind. Variabla e cila ka fokusin më të madh në këtë temë është variabla e parë e cila është variabël e varur ku do të studiohet edhe ndikimi i variablave të pavarura në të.

Tabela 11: Statistikat përshkruese

<i>Variable</i>	<i>Observation</i>	<i>Mean</i>	<i>S.Deviation</i>	<i>Minimum</i>	<i>Maximum</i>
Cilat janë rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohet biznesi juaj?	46	2.59	1.78	1	6
Si i identifikoni dhe i vlerësoni ju këto rreziqe në biznesin tuaj?	46	1.67	.47	1	2
Cilat strategji të menaxhimit të rrezikut përdorni për të mbrojtur investimet tuaja?	46	2.11	.57	1	3
Si ndikojnë rreziqet e papritura në strategjitë tuaja të menaxhimit të rrezikut?	46	2.28	1.17	1	5
Si e matni suksesin e strategjive tuaja të menaxhimit të rrezikut?	46	2.33	.92	1	4
A keni njohuri mbi metodat të cilat përdoren për matjen dhe vlerësimin e rrezikut?	46	1.61	.85	1	4
Cili është pozicioni juaj në biznes?	46	1.35	.64	1	3
Gjinia juaj?	46	1.17	.38	1	2
Cila është madhësia e biznesit tuaj?	46	1.35	.60	1	3
Përvoja juaj në menaxhimin financiar?	46	3.28	1.05	1	4

Burimi: Kalkulimet e autorit

2.4. Korrelacionet

Për të kuptuar lidhjen në mes të variablave në këtë temë u aplikua analiza e korrelacionit. Koeficientët e korrelacionit janë paraqitur në tabelën 12. Në bazë të gjeturave në këtë analizë mund të shohim se rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohen bizneset ka lidhje pozitive me identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, strategjitë për mbrojtjen e investimeve, rreziqet e papritura, matjen e sukseseve të strategjive të menaxhimit të rrezikut, madhësinë e biznesit dhe përvojën mbi menaxhimin, ndërsa ndërlidhje negative ky korrelacion ka me metodat për matjen dhe vlerësimin e rrezikut, pozicionin në biznes dhe gjininë. Më pas, identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve në këtë analizë ka lidhje pozitive me strategjitë për mbrojtjen e investimeve dhe përvojën mbi menaxhimin, ndërsa ka lidhje negative me rreziqet e papritura, matjen e sukseseve të strategjive të menaxhimit të rrezikut, metodat për matjen dhe vlerësimin e rrezikut, pozicionin në biznes, gjininë dhe madhësinë e biznesit. Për më tepër, strategjitë për mbrojtjen e investimeve ka korrelacion pozitiv me rreziqet e papritura dhe përvojën mbi menaxhimin, ndërsa korrelacion negativ ka me matjen e sukseseve të strategjive të menaxhimit të rrezikut, metodat për matjen dhe vlerësimin e rrezikut, pozicionin në biznes, gjininë dhe madhësinë e biznesit. Tutje, rreziqet e papritura kanë ndërlidhje negative me matjen e sukseseve të strategjive të

menaxhimit të rrezikut, metodat për matjen dhe vlerësimin e rrezikut, pozicionin në biznes, gjininë, madhësinë e biznesit dhe përvojën mbi menaxhimin. Më pas, matja e sukseseve të strategjive të menaxhimit të rrezikut ka ndërlidhje pozitive me përvojën mbi menaxhimin dhe gjininë, ndërsa ka lidhje negative me metodat për matjen dhe vlerësimin e rrezikut, pozicionin në biznes dhe madhësinë e biznesit. Metodatat për matjen dhe vlerësimin e rrezikut ka korrelacion pozitiv me pozicionin në biznes, gjininë dhe madhësinë e biznesit, ndërsa ka korrelacion negative vetëm me përvojën mbi menaxhimin. Tutje, pozicioni në biznes ka ndërlidhje pozitive me gjininë, ndërsa lidhje negative ka me madhësinë e biznesit dhe përvojën mbi menaxhimin. Më pas, gjinia ka lidhje pozitive me madhësinë e biznesit, ndërsa lidhje negative ka me përvojën mbi menaxhimin. Dhe së fundi, madhësia e biznesit ka lidhje negative me përvojën mbi menaxhimin. Analiza e korrelacionit ka dhënë njohuri të vlefshme mbi marrëdhëniet midis variablave, duke ofruar kuptim të qartë mbi dinamikën e këtyre variablave.

Tabela 12: Cilat janë rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohen bizneset

	<i>Y</i>	<i>X1</i>	<i>X2</i>	<i>X3</i>	<i>X4</i>	<i>X5</i>	<i>X6</i>	<i>X7</i>	<i>X8</i>	<i>X9</i>
<i>Y</i>	1.0000									
<i>X1</i>	0.1526	1.0000								
<i>X2</i>	0.2432	0.1349	1.0000							
<i>X3</i>	0.0680	-0.1510	0.0533	1.0000						
<i>X4</i>	0.1380	-0.0565	-0.0269	-0.0670	1.0000					
<i>X5</i>	-0.1228	-0.0476	-0.1852	-0.0648	-0.0883	1.0000				
<i>X6</i>	-0.2217	-0.1306	-0.0453	-0.3129	-0.3100	0.2134	1.0000			
<i>X7</i>	-0.0551	-0.1702	-0.1913	-0.0626	0.0247	0.0088	0.1103	1.0000		
<i>X8</i>	0.1156	-0.1383	-0.1128	-0.0164	-0.0486	0.0112	-0.1474	0.2128	1.0000	
<i>X9</i>	0.2662	0.3242	0.1343	-0.0304	0.0637	-0.2211	-0.2826	-0.2914	-0.1588	1.0000

Burimi: Kalkulimet e autorit

2.5. Analiza e regresionit

Në këtë temë është përdorur edhe analiza e regresionit linear për të kuptuar më thellësisht marrëdhënien ndërmjet variablës së varur dhe variablave të pavarura. Në këtë pike të analizës do të vazhdojmë me komentimin e testeve që janë përdorur. Përmbledhja e modelit ndihmon që të kuptojmë cilësinë dhe fuqinë që lidhen me performancën e regresionit. Anova përdoret për të kuptuar rëndësinë statistikore të modelit të regresionit dhe tregon përqindjen e variacionit të variablës së varur. Më poshtë do të shohim një përmbledhje të detajuar të analizës bazuar në të dhënat që kemi. Në tabelën 13, mund të shohim se në analizën e regresionit linear. $R^2 = 0.182$ që tregon se ekziston një variacion mes variablës së varur dhe variablave të pavarur prej 18.2%. Gjithashtu,, në kuadër të kësaj analize është aplikuar dhe testi Anova, ku $F = 5.893$ dhe

$p = 0.0041$ që tregon se ky test i regresionit luan një rol të rëndësishëm në këtë analizë sepse variablat e pavarura kanë ndikim të rëndësishëm mbi variablën e varur. Këto rezultate dëshmojnë se aplikimi i këtyre modeleve është adekuat në këtë analizë.

Tabela 13: Analiza e regresionit

Variables	Coefficient	P – value
Si i identifikoni dhe i vlerësoni ju këto rreziqe në biznesin tuaj?	0.352	0.441
Cilat strategji të menaxhimit të rrezikut përdorni për të mbrojtur investimet tuaja?	0.708	0.577
Si ndikojnë rreziqet e papritura në strategjitë tuaja të menaxhimit të rrezikut?	0.117	0.003
Si e matni suksesin e strategjive tuaja të menaxhimit të rrezikut?	0.258	0.025
A keni njohuri mbi metodat të cilat përdoren për matjen dhe vlerësimin e rrezikut?	-0.005	0.988
Cili është pozicioni juaj në biznes?	-0.131	0.004
Gjinia juaj	0.174	0.820
Cila është madhësia e biznesit tuaj?	0.539	0.268
Përvoja juaj në menaxhimin financiar?	0.384	0.006
Constant	-2.370	0.441
R^2		0.182
F	5.893	.0041

Burimi: Kalkulimet e autorit

KAPITULLI I TRETË: TË GJETURAT DHE DISKUTIMET

Në bazë të të gjeturave në tabelën 12, mund të shohim se ndikim të rëndësishëm pozitiv në aspektin statistikor kanë identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve, strategjitë për mbrojtjen e investimeve, rreziqet e papritura, matja e sukseseve të strategjive të menaxhimit të rrezikut, madhësia e biznesit, dhe përvoja në ndërmarrje. Ndërkaq, variablat me ndikim jo të rëndësishëm statistikor janë metodat për matjen dhe vlerësimin e rrezikut, pozicionin në biznes dhe struktura gjinore.

Rezultatet në këtë studim tregojnë se variabla si i identifikoni dhe i vlerësoni ju këto rreziqe në biznesin tuaj është statistikisht e rëndësishme tek variabla e varur me vlerën e koeficientit 0.352 paraqet korrelacion pozitiv ($p = 0.041$) dhe me një interval besueshmërie 95%. Kjo do të thotë që identifikimi i rreziqeve në kuadër të biznesit ndikon në mënyrë positive në vlerësimin e rreziqeve në investime financiare. Nga kjo mund të themi se këto rezultate lidhen dhe me rezultatet e autorëve që janë paraqitur tek rishikimi i literaturës në kapitullin e pare (Komisionerët publikë, 2022).

Më pas, variabla strategjitë të menaxhimit të rrezikut për të mbrojtjen e investimeve, me vlerën e koeficientit 0.708 ka ndërlidhje pozitive dhe paraqet një efekt relativisht të pa rëndësishëm statistikor ndaj variablës së varur ($p = 0.577$). Nga kjo mund të themi se aplikimi i strategjive mbi menaxhimin e rrezikut ndikon pozitivisht në vlerësimin e rreziqeve në investime financiare dhe ka ndërlidhje me rezultatet e autorit (Hopkin, 2017).

Tutje, variabla ndikimi i rreziqeve të papritura në strategjitë të menaxhimit të rrezikut, vlera e koeficientit e të cilit është 0.117 përbënë lidhje negative dhe ka një ndikim të rëndësishëm statistikisht tek variabla e varur ($p = 0.003$) me interval besueshmërie 95%. Kjo bënë që rreziku i papritur ndikon negativisht në strategjinë e menaxhimit të investimeve financiare. Tek variabla si e matni suksesin e strategjive tuaja të menaxhimit të rrezikut, me vlerën e koeficientit 0.258 ka ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në variablën e varur ($p = 0.025$) me intervalin e besueshmërisë 95%. Nga kjo rrjedh se matja dhe vlerësimi i strategjive të aplikuara ndikojnë pozitivisht në vlerësimin e rrezikut në investimet financiare.

Variabla njohuritë mbi metodat të cilat përdoren për matjen dhe vlerësimin e rrezikut, me vlerën e koeficientit -0.005 paraqet ndikim negativ dhe të pa rëndësishëm

statistikisht në variablën e varur, duke u bazuar ($p = 0.988$). Kjo do të thotë që njohuritë mbi metodat e aplikuara në vlerësimin e rrezikut ndikojnë negativisht në vlerësimin e rrezikut në investime financiare. Këto rezultate përputhen me (Shkrepa dhe Dhana, 2015) dhe (Dhuci, 2015).

Gjithashtu, rezultatet treguan se variabla cili është pozicioni juaj në biznes, me vlerën e koeficientit -0.131 ka korrelacion pozitiv por që ka ndikim jo të rëndësishëm statistikor në rreziqet në të cilat ballafaqohen bizneset ($p = 0.004$) me nivel të besueshmërisë 99%. Nga kjo mund të themi se pozita e strukturës udhëheqëse brenda biznesit ndikon pozitivisht në vlerësimin e rrezikut në investimet financiare por nuk ka ndikim të rëndësishëm statistikor mbi variablën e varur.

Ndërlidhje negative në këtë analizë në rreziqet financiare që përballen bizneset dhe që paraqet ndikim jo të rëndësishëm statistikisht në këtë model është struktura gjinore, me vlerën e koeficientit 0.174 dhe vlera ($p = 0.820$). Pra, struktura gjinore ndikon negativisht në vlerësimin e rrezikut në investimet financiare.

Tutje, variabla cila është madhësia e biznesit tuaj, me vlerën e koeficientit 0.539 ka ndërlidhje negative dhe gjithashtu me ndikim jo të rëndësishëm statistikor ($p = 0.268$). Kjo bënë që madhësia e biznesit është e ndërlidhur negativisht me vlerësimin e rrezikut në investimet financiare. Dhe në fund, variabla përvoja juaj në menaxhimin financiar, me vlerën e koeficientit 0.384 ka korrelacion pozitiv dhe të rëndësishëm në variablën e varur ($p = 0.006$) me një nivel të besueshmërisë. Pra, përvoja në menaxhim të biznesit ndikon pozitivisht në vlerësimin e rrezikut në investimet financiare.

KAPITULLI I KATËR: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

4.1. Konkluzione

Ky punim diplome ka pasur qëllim që të analizoj rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohen bizneset në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj, duke përfshirë analizën e korrelacionit dhe analizën e regresionit. Gjithashtu, në këtë hulumtim janë trajtuar faktorë të ndryshëm të rrezikut të cilët kanë ndikim të madh mbi performancën dhe qëndrueshmërinë e një ndërmarrje, duke përfshirë analizën e rreziqeve të brendshme dhe të jashtme. Menaxhimi i rrezikut është një nga proceset më të rëndësishme në mënyrë që një ndërmarrje të funksionojë me efikasitet dhe që të ruajë stabilitetin financiar.

Nga rezultatet në këtë analizë mund të konkludojmë se rreziqet e jashtme dhe rreziqet e brendshme janë të ndërlidhura në suksesin e një ndërmarrje. Rreziku operacional është njëra nga rreziqet që ndërmarrjet ballafaqohen më së shumti në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj, kjo ndodhë për shkak të faktorëve të ndryshëm të cilat mund të jenë teknologjikë, punonjësit të pandërgjegjshëm si dhe gjithashtu problemet me furnizuesit. Identifikimi dhe menaxhimi jo në kohën e duhur nga ana e departamentit të riskut mund të ketë pasoja të rënda në portfolion dhe qëndrueshmërinë e ndërmarrjes.

Gjithashtu, monitorimi i vazhdueshëm dhe në mënyrë të rregullt nga ana e menaxhmentit në rrezikun e tregut si dhe të valutës është thelbësore sipas rezultateve të gjetura në këtë punim. Kjo ndodhë për arsye sepse janë të ndërlidhura me ndryshimet në tregun global dhe normat e këmbimit. Pra, këto rreziqe bëjnë pjesë në rreziqet e jashtme ku ndryshimet e papritura sjellin pasoja të rënda në fitimin e ndërmarrjes dhe në operacionet e saj. Andaj, këto rreziqe kërkojnë një qasje të strukturuar për mbrojtjen dhe diversifikimin e tyre.

Tutje, sipas rezultateve rreziku i likuiditetit dhe rreziku i kredisë janë gjithashtu dy faktorë të rëndësishëm të cilët ndikojnë në stabilitetin financiar të ndërmarrjeve. Luhatjet në normat e interesit është një nga faktorët që mund të ndikojë negativisht në aftësinë e bizneseve për të shlyer borxhet. Prandaj, është e rëndësishme që ndërmarrjet të ndjekin me strategji të forta të menaxhimit të këtyre rreziqeve. Gjithashtu, rreziku i likuiditetit përfaqëson mundësinë që ndërmarrjet në një kohë të caktuar të mos ketë fonde të mjaftueshme për t'i përmbushur detyrimet e saj afatshkurtra. Sipas gjetjeve,

rreziku i likuiditetit është një faktor i rëndësishëm që ndikon në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e një biznesi. Prandaj, ky faktor kërkon mbajtjen e rezervave të mjaftueshme likuiditeti dhe monitorimin e vazhdueshëm nga ana e menaxhmentit financiar për të shmangur kështu çdo ndërlikim që bizneset mund të përballen. Rezultatet e kësaj analize theksuan se procesi i menaxhimit të rrezikut apo strategjitë të menaxhimit të rrezikut luajnë një rol kyç në mbrojtjen e rreziqeve me të cilat ballafaqohen bizneset në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj. Identifikimi i rreziqeve, analiza dhe vlerësimi i rrezikut, trajtimi i rreziqeve dhe monitorimi paraqesin procesin thelbësor për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e stabilitetit financiar duke ndihmuar në parandalimin e humbjeve dhe duke ndikuar në performancën e ndërmarrjeve si pasojë e faktorëve të ndryshëm. Rishikimi dhe monitorimi në mënyrë të rregullt të strategjive të menaxhimit të rrezikut krijon një strukturë të qëndrueshme dhe të fortë gjatë përballjes me sfidat e reja që shfaqen tek ndërmarrjet. Aplikimi i strategjive të menaxhimit të rrezikut në një ndërmarrje apo biznes në mënyrë efektive ndihmon në stabilitetin financiar, humbjet e papritura etj.

4.2.Rekomandime

Bazuar në rezultatet të nxjerrura në analizën mbi rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohen bizneset dhe strategjitë mbi menaxhimin e rrezikut në këtë punim, rekomandoj:

- Zhvillimin e një strategjie më të qëndrueshme mbi menaxhimin e rrezikut në mënyrë që të parandalojnë rreziqet e papritura që të mos kenë ndikim të madh në afarizmin e ndërmarrjes dhe në investimet financiare.
- Zhvillimin e një sistemi të avancuar për të identifikuar rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohen bizneset në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj dhe për të menaxhuar në mënyrë efektive rreziqet e brendshme dhe rreziqet e jashtme.
- Krijimin e një departamenti të veçantë dhe të posaçëm mbi menaxhimin e rrezikut, i cili do të fokusohet në zhvillimin e strategjive të reja duke parandaluar dhe menaxhuar kështu rreziqet të cilat vijnë, dhe monitorimin e vazhdueshëm të rreziqeve .
- Përdorimin e teknologjisë për parashikimin e rreziqeve, i cili ndihmon për të përmirësuar dhe për të vlerësuar ndikimin e rreziqeve. Kjo ndikon që

departamenti i riskut përmes kësaj të marrë masa në investimet financiare dhe për të reduktuar këto rreziqe.

- Trajnime të vazhdueshme të stafit mbi menaxhimin e rrezikut për të siguruar në mënyrë që strategjitë të menaxhimit të rrezikut që të jenë efektive dhe të qëndrueshme për të identifikuar dhe për të menaxhuar këto rreziqe.
- Identifikimi dhe monitorimi në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme të rreziqeve me të cilat ballafaqohen bizneset.
- Implementimi i një plani dhe sigurimi ndaj rreziqeve të tregut, rreziqeve të kredisë, rreziqeve operacionale, rreziqeve të valutës dhe rreziqeve të likuiditetit për të kujdesur në periudhat të vështira dhe të paqëndrueshme në investimet financiare.
- Krijimi i politikave më të qëndrueshme mbi menaxhimin e rrezikut dhe strategjitë të menaxhimit të rrezikut për të mbajtur një pozicion më të fortë financiar në investimet financiare.
- Kontrollin efikas të strategjive të menaxhimit të rrezikut për të mbrojtur në periudha të ndryshme investimet financiare.

REFERENCA

Paul Hopkin, (2027). Fundamentals of Risk Management. Understanding, evaluating and implementing effective risk management. 4th Edition.

Eugene E Brigham, Michael C. Ehrhardt, (2017). Financial Management. Theory and Practice.

Orfea Dhuci, (2015). Teoria e riskut. Njohuritë bazë për riskun dhe drejtimin e tij.

Brian Beers, (2022). How Companies Can Reduce Internal and External Business Risk. <https://www.investopedia.com/ask/answers/050115/how-can-companies-reduce-internal-and-external-business-risk.asp>.

Indeed Editorial Team, (2024). 10 Types of Business Risks and How to Manage Them. <https://www.indeed.com/career-advice/career-development/risks-business>.

Jean – Louis Amelon, (2006). Drejtimi financiar i ndërmarrjeve dhe i shoqërive

Irma SHKREPA, Marko DHANA, (2015). Manuali i menaxhimit të riskut. Guida, Instruksione, Instrumenta dhe Teknika të Menaxhimit të Riskut. <https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/09/Manual-Risku-Fundi.pdf>.

Komisionerët publikë, (2022). Strategjia E Menaxhimit të riskut 2023 – 2025. <https://ikp.al/wp-content/uploads/2023/02/Strategjia-e-menaxhimit-t%C3%AB-riskut-2023-2025-final-web.pdf>.

Vilma Nasteckiene, (2021). Empirical Investigation of Risk Management Practices. <https://hrcak.srce.hr/file/386604>.

Kontrolli i lartë i shtetit, (2018). Strategjia Menaxhimit të Riskut për KLSH (e rishikuar). Republika e Shqipërisë. <https://panel.klsh.org.al/storage/phpgmkDCj.pdf>.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, (2024). Manual praktik për Vlerësimin e Riskut në punë. <https://inspektoratiipunës.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Manual-per-vleresimin-e-riskut-me-steme-300718.pdf>.

James Chen, (2024). Risk: What It Means in Investing, How to Measure and Manage It. <https://www.investopedia.com/terms/r/risk.asp>.

Linda Tucci, (2023). What is risk management and why is it important? Tech target.
<https://www.techtargget.com/searchsecurity/definition/What-is-risk-management-and-why-is-it-important#:~:text=is%20it%20important%3F-.Risk%20management%20is%20the%20process%20of%20identifying%2C%20assessing%20and%20controlling,errors%2C%20accidents%20and%20natural%20disasters.>

Robert S. Kaplan, Anette Mikes, (2012). Managing Risks: A New Framework.
<https://hbr.org/2012/06/managing-risks-a-new-framework>.

IRM, (2002). A Risk Management Standard

SHTOJCË

PYETËSOR HULUMTUES

Të nderuar pjesëmarrës,

Duke pasur parasysh mjedisin kompleks dhe të paqëndrueshëm ekonomik, menaxhimi në mënyrë efektive dhe të suksesshëm është njëra nga sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohen bizneset në Kosovë. Në kuadër të kësaj, përdorimi i strategjive efektive të menaxhimit të rrezikut është thelbi kryesor për mbrojtjen e investimeve dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të bizneseve.

Ky studim ka për qëllim për të identifikuar dhe për të menaxhuar rreziqet kryesore financiare me të cilat përballen bizneset në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj gjatë afarizimit të tyre. Hulumtimi synon që të analizojë mënyrën se si bizneset në Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj vlerësojnë rrezikun dhe cilat strategji përdorin për të reduktuar rreziqet që ballafaqohen këto biznese, andaj ju ftoj që të merrni pjesë në këtë studim të rëndësishëm kërkimor mbi qasjen e rrezikut.

Pjesëmarrja në këtë hulumtim është plotësisht vullnetare dhe të dhënat e mbledhura do të përdoren për qëllime akademike dhe do të trajtohen me konfidencialitet të plotë. Kontributi juaj në këtë studim ndihmon përmirësimin e njohurive mbi riskun e bizneseve dhe ndihmon në zhvillimin e strategjive të efektshme.

Faleminderit për kohën dhe kontributin tuaj!

Gentijana Aruqi

Universiteti 'Isa Boletini' – Mitrovicë

Studimet Bachelor, Biznes dhe Menaxhment

SEKSIONI 1. Të dhënat mbi biznesin

1.Emri i biznesit

2.Lokacioni i biznesit

- a) Mitrovicë
- b) Vushtrri
- c) Skenderaj

3.Cili është pozicioni juaj në biznes?

- a) Menaxher / CEO
- b) Pronar
- c) Tjetër

4.Gjinia juaj

- a) Femër
- b) Mashkull

5.Cila është madhësia e biznesit tuaj?

- a) Mikro ndërmarrje (1 – 9 punonjës)
- b) Ndërmarrje e Vogël (10 – 49 punonjës)
- c) Ndërmarrje e Mesme (50 – 249 punonjës)
- d) Ndërmarrje e Madhe (250+ punonjës)

6.Përvoja juaj në menaxhimin financiar?

- a) Më pas se 1 vit
- b) 1 – 3 vite
- c) 3 – 5 vite
- d) Më shumë se 5 vite

SEKSIONI 2. Identifikimi i rreziqeve me të cilat ballafaqohen bizneset

7.Cilat janë rreziqet kryesore financiare me të cilat ballafaqohet biznesi juaj?

- a) Rreziku i tregut
- b) Rreziku i kredisë
- c) Rreziku i likuiditetit
- d) Rreziku i valutës
- e) Rreziku operacional
- f) Tjetër (specifikoni)

8.Si i identifikoni dhe i vlerësoni ju këto rreziqe në biznesin tuaj?

- a) Konsultimi me ekspertë
- b) Analiza statistikore

9.Cilat strategji të menaxhimit të rrezikut përdorni për të mbrojtur investimet tuaja?

- a) Diversifikimi i rrezikut
- b) Vlerësimi dhe Monitorimi
- c) Mbrojtja nga rreziku

10.Cilat metoda përdorni për të paashikuar rreziqet financiare në biznesin tuaj?

SEKSIONI 4. Ndikimi i rreziqeve të papritura në performancën e bizneseve

11.Si ndikojnë rreziqet e papritura në strategjitë tuaja të menaxhimit të rrezikut?

- a) Kërkojnë rishikim dhe ndryshim të plotë të strategjive ekzistuese
- b) Kërkojnë ndryshime të pjeshme dhe përshtatje të strategjive aktuale
- c) Kërkojnë vetëm përmirësime të vogla në strategjitë aktuale
- d) Nuk kërkojnë ndryshime në strategjitë aktuale
- e) Nuk jam i sigurt se si ndikojnë

12.Sa shpesh rishikoni dhe përditësoni strategjitë tuaja të menaxhimit të rrezikut?

- a) Çdo muaj
- b) Çdo tre muaj
- c) Çdo gjashtë muaj
- d) Çdo vit
- e) Vetëm kur ka ndryshime të mëdha në treg

SEKSIONI 4. Matja e strategjive të menaxhimit të rrezikut

13.Si e matni suksesin e strategjive tuaja të menaxhimit të rrezikut?

- a) Analiza e kthimit mbi investimin
- b) Reduktimi i humbjeve financiare
- c) Stabiliteti dhe qëndrueshmëria e portofolit
- d) Komentet dhe raportet nga auditimet e jashtme

14.Cilat ndryshime do të bënit në strategjitë tuaja të menaxhimit të rrezikut bazuar në përvojën tuaj dhe kushtet aktuale të tregut?

15.A keni njohuri mbi metodat të cilat përdoren për matjen dhe vlerësimin e rrezikut?

- a) Distribuimi i probabilitetit
- b) Kthimi i pritur
- c) Devijimi standard
- d) Koeficienti i variacionit

16.A keni ndonjë koment shtesë ose sugjerim në lidhje me menaxhimin e rrezikut në investime financiare?
